



# The New Law on Beneficial Owners in Albania

## Law on the Register of Beneficial Owners

The Law "On the Register of Beneficial Owners" is approved.

### Reporting Entities

According to this law, with the exception of natural persons, legal entities and enterprises, whose sole shareholder is the central and / or local institution of the Republic of Albania, religious communities and political parties, the following entities have the obligation to report / register the beneficial owners :

- limited liability companies;
- joint stock companies;
- collective companies;
- limited partnerships;
- representative offices and branches of foreign companies;
- savings and loan associations and their unions;
- mutual cooperation societies;
- agricultural cooperatives;
- any other legal entity, which by law is obliged to register with the NBC;
- non-profit organizations, etc.

*"Beneficiary owner" shall mean the individual who owns or ultimately controls the entity and / or the individual in whose name a transaction or activity is being conducted.*

### Deadline for Registration

Existing reporting entities must identify their beneficial owners and create and maintain relevant documents for them by 31 December 2020. However, the deadline for registering the required data for the beneficial owners is within 60 calendar days from the date of the set up of the Register of Beneficial Owner (which is expected by 31 January 2021).

Newly registered entities should report the data related to the beneficial owners within 30 days from the date of registration. In addition to the initial records, entities are required to report any changes to this data within 30-days from the date of change.

### Access to the Register of Beneficial Owners

Except for data that is freely accessible such as name, surname, citizenship, etc., all other data are accessed only by the beneficial Owner, or persons authorized by him, as well as by the competent state authorities.

## Ligji për Regjistrin e Pronarëve Përfitues

Ligji "Për Regjistrin e Pronarëve Përfitues" është miratuar.

### Subjektet Raportuese

Sipas këtij ligji, me përjashtim të personave fizikë, personave juridikë dhe ndërmarrjeve, aksionari i vetëm i të cilëve janë institucionet qendrore dhe/ose vendore të Republikës së Shqipërisë, komuniteteve fetare dhe partive politike, subjektet e mëposhtme kanë detyrimin të raportojnë/regjistrojnë pronarët përfitues:

- shoqëritë më përgjegjësi të kufizuar;
- shoqëritë aksionare;
- shoqëritë kolektive;
- shoqëritë komandite;
- zyrat e përfaqësimit dhe degët e shoqërive të huaja;
- shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre;
- shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë;
- shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor;
- çdo subjekt tjetër juridik, i cili me ligj detyrohet të regjistrohet pranë QKB-së;
- organizatat jofitimprurëse, etj.

*"Pronar përfitues" do të konsiderohet individi i cili ka në pronësi ose kontrollon i fundit subjektin dhe/ose individi në emër të të cilit po kryhet një transaksion ose veprimtari.*

### Afati i Caktuar për Regjistrim

Subjektet raportuese ekzistuese duhet të identifikojnë pronarët përfitues dhe të krijojnë e të mbajnë dokumentet përkatëse për ta, jo më vonë se data 31 dhjetor 2020. Megjithatë, afati për regjistrimin e të dhënave të kërkuara për pronarët përfitues është brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve kalendarike nga data e krijimit të Regjistrit të Pronarëve Përfitues (që pritet të jetë data 31 janar 2021).

Subjektet e regjistruar për herë të parë duhet të raportojnë të dhënat për pronarët përfitues brenda 30 ditëve nga data e regjistrimit. Përveç regjistrimeve fillestare, subjektet kanë detyrimin të raportojnë për çdo ndryshim në këto të dhëna brenda afatit 30-ditor nga data e regjistrimit të ndryshimit.

### Aksesi në Regjistrin e Pronarëve Përfitues

Përveç të dhënave që aksesohen lirisht si emri, mbiemri, shtetësia etj., të gjitha të dhënat e tjera aksesohen vetëm nga pronari përfitues, ose persona të autorizuar prej tij, si dhe nga autoritetet shtetërore kompetente.



### The Competent Authority for Registry Administration

The Register of Beneficial Owners is administered by the National Business Center, which will be the competent authority for the registration of the declared data.

The NBC may accept or reject a registration within 2 (two days) from the date of registration.

At the written request of the interested party, the NBC issues extracts on the data that are freely accessible.

### Registered Beneficiary Owner Rights and Administrative Complaint

The Registered Beneficiary Owner enjoys the following rights:

- to file a lawsuit against the reporting entity before the competent court in case he claims that he is not the beneficial owner of this entity. Upon issuance of the decision by the court, the NBC makes the relevant corrections;
- to appeal administratively against the actions or omissions of the NBC within 30 calendar days from the date of publication in the Register of the decision to accept or reject the registration;
- to complain administratively in cases of non-issuance of the extract by the competent authority.

\* An administrative appeal can not be filed earlier than 7 calendar days and not later than 45 calendar days from the date of expiration of the deadline set for the issuance of the extract.

### Sanctions for Failure to Fulfill Legal Obligations

A penalty in the amount of ALL 50,000 - ALL 500,000 is imposed to the entities that fail to comply with the legal provisions of this law. Legal representatives of the registered entities are also subject to sanctions, and the penalties are doubled if the violation occurs more than twice.

\* The Register of Beneficial Owners is expected to be created no later than 31 January 2021.

[Source: Law no.112/2020 "On the Register of Beneficial Owners", dated 13.08.2020, official gazette no.149]

---

[www.pwc.com/al](http://www.pwc.com/al). This information is intended only as a general update for interested persons and should not be used as a basis for decision-making. For further details please contact PwC Albania at: [pwc.albania@al.pwc.com](mailto:pwc.albania@al.pwc.com). All rights reserved. PwC refers to the Albanian member firm, and may sometimes refer to the PwC network. Each member firm is a separate legal entity. Please see [www.pwc.com/structure](http://www.pwc.com/structure) for further details

### Struktura Përgjegjëse për Administrimin e Regjistrimit

Regjistri i Pronarëve Përfitues administrohet nga Qendra Kombëtare e Biznesit, e cila do të jetë struktura kompetente për regjistrimin e të dhënave të deklaruara.

QKB-ja mund ta pranojë ose refuzojë një regjistrim brenda 2 (dy ditëve) nga data e regjistrimit.

Me kërkesën me shkrim të të interesuarit, QKB-ja lëshon ekstrakte mbi të dhënat që janë lirisht të aksesueshme.

### Të Drejtat e Pronarit Përfitues të Regjistruar dhe Ankimi Administrativ

Pronari Përfitues i Regjistruar gëzon të drejtat e mëposhtme:

- të ngrejë padi ndaj subjektit raportues para gjykatës kompetente në rast se pretendon se ai nuk është pronari përfitues i këtij subjekti. Me dhënien e vendimit nga gjykata, QKB-ja bën korrigjimet përkatëse;
- të ankohet në rrugë administrative ndaj veprimeve apo mosveprimeve të QKB-së brenda 30 ditëve kalendarike nga data e publikimit në Regjistër të vendimit për pranimin apo refuzimin e regjistrimit;
- të ankohet në rrugë administrative në rastet e mos lëshimit të ekstraktit nga ana e autoritetit kompetent.

\*Pala nuk mund të kryejë ankimin administrativ më herët se 7 ditë kalendarike dhe jo më vonë se 45 ditë kalendarike nga data e përfundimit të afatit të caktuar për lëshimin e ekstraktit.

### Sanksionet për Mospërbushje të Detyrimeve Ligjore

Mosrespektimi i parashikimeve ligjore të këtij ligji sjell gjorbitjen e subjekteve përkatëse me gjobë nga 50 000- 500 000 lekë. Përfaqesuesit ligjorë të subjekteve të regjistruara, person juridik, janë gjithashtu objekt sanksioni, dhe gjobat e vendosura dyfishohen nëse shkelja përsëritet më shumë se dy herë.

\* Regjistri i Pronarëve Përfitues pritet të krijohet jo më vonë se data 31 Janar 2021.

[Burimi: Ligji Nr. 112/2020 për "Regjistrin e Pronarëve Përfitues", datë 13.08.2020, fletorja zyrtare nr.149]

---

[www.pwc.com/al](http://www.pwc.com/al). Ky informacion ka për qëllim një përditësim të përgjithshëm për personat e interesuar dhe nuk duhet të përdoret si bazë për vendimmarrje. Për detaje të mëtejshme, ju lutemi të kontaktoni PwC Albania në: [pwc.albania@al.pwc.com](mailto:pwc.albania@al.pwc.com). Të gjitha të drejtat e rezervuara. PwC i referohet firmës anëtare shqiptare, dhe ndonjëherë mund t'i referohet edhe rrjetit PwC. Çdo firmë anëtare është një entitet juridik i veçantë. Ju lutem të shikoni [www.pwc.com/structure](http://www.pwc.com/structure) për detaje të mëtejshme.